

Decentralizimi i qeverisjes vendore

Burimet financiare dhe shërbimet për qytetarët

Investimet dhe përmisimi i cilësisë të jetesës së qytetarëve

Llogaridhënia dhe transparencja

Sfida e rradhës: Zgjedhjet vendore 2019

FINANCAT PUBLIKE VENDORE 2018

STATUS RAPORT

Tabela e përmbajtjes

<i>Shënim metodologjik</i>	4
1. Hyrje	5
2. Burimet financiare totale për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave	6
2.1 Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore.....	8
2.1.1 Të ardhurat nga taksat vendore.....	13
2.1.2 Të ardhurat nga tarifat vendore.....	20
2.1.3 Huamarrja vendore dhe detyrimet e prapambetura.....	22
2.2 Të ardhurat nga taksat e ndara.....	24
2.3 Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike.....	25
2.4 Të ardhurat nga transfertat e kushtëzuar.....	28
2.5 Burimet financiare totale.....	29
3. Shpenzimet vendore	32
3.1 Shpenzimet sipas burimit të financimit.....	34
3.2 Shpenzimet e kryera me fonde nga burimet vendore.....	36
3.2.1 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit ekonomik.....	36
3.2.2 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit funksional.....	41
3.3 Shpenzimet e kryera me fonde nga transfertat të kushtëzuara.....	44
3.4 Kosto e qeverisjes vendore në fund të vitit 2018.....	47
4. Përfundime	48
<i>Shtojcë 1. Shpenzimet me fonde të veta për frymë</i>	49
<i>Shtojcë 2. Shpenzimet kapitale me fonde të veta për frymë</i>	51
<i>Shtojcë 3. Të ardhura nga burime të veta vendore për frymë</i>	53

Shënim metodologjik

Burimi i të dhënave për njësitë e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë (bashkitë) është Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (Sistemi i Thesarit, SIFQ) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë përpunuar dhe më pas publikuar në platformën www.financatvendore.al. Të dhënat e konsoliduara janë kumulative (ose stok në fund të periudhës), të shprehura në monedhë vendase (lekë) dhe u referohen vetëm 61 bashkive (12 qarqet nuk janë të përfshirë në analizë). Për të mundur krahasimet historike me periudhën përpara zbatimit të reformës administrative dhe territoriale (RAT), të dhënat për periudhën 2010-2015 për 373 njësi të vetëqeverisjes vendore u ri-klasifikuan në nivelin e 61 bashkive.¹

Për qëllime analize të dhënat e marra nga SIFQ në formë bruto janë klasifikuar nga autorët duke ndjekur gjerësisht përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe praktikën ndërkombëtare përkatëse.² Të dhënat për të ardhurat janë kategorizuar në përputhje me sa lartpërmendur në:

- të ardhura nga burime të veta vendore që përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, tarifat, huamarrje vendore dhe të tjera;
- taksa të ndara sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- transferta të pakushtëzuara dhe specifike; dhe
- transferta të kushtëzuara nga ministrinë e linjës për funksione të deleguara.

Tre kategoritë e para janë klasifikuar nën emërtimin e përbashkët të burimeve financiare të disponueshme, burime mbi të cilat bashkitë kanë të drejta vendimmarrjeje relative në lidhje me mënyrën e përdorimit. Ndërsa, mbi kategorinë e transfertave të kushtëzuara bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrjeje në lidhje me sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve; pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës (ndryshe, me destinacion të përcaktuar).

Për simetri me mënyrën e organizimit të të dhënave mbi të ardhurat sipas burimit, analiza e shpenzimeve do të organizohet në dy kategori kryesore:

- shpenzime të kryera me fonde të veta të bashkive (ku përfshihen të ardhurat nga burimet e veta, taksat e ndara, transferta e pakushtëzuar dhe specifike) dhe,
- shpenzime të kryera me fonde të kushtëzuara (ku do të përfshihen ato kategori shpenzimesh të mbuluara me fonde nga transfertat e kushtëzuara nga ministrinë e linjës, përfshirë fondet për investime nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR)).

Për të dy kategoritë, si me fonde të veta ashtu dhe me fonde të kushtëzuara, shpenzimet do të paraqiten sipas natyrës ekonomike të tyre dhe sipas funksioneve të qeverisjes vendore (COFOG).

Ky raport është pjesë e një serie raportesh me frekuencë tremujore dhe vjetore për financat vendore të përgatitur nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Raportet e mëparshme mund të gjenden në: <http://www.financatvendore.al/pub/raporte>.

Për një panoramë të përgjithshme për secilën prej 61 bashkive, mund të konsultoni Profilin e Bashkive në: <http://www.financatvendore.al/analiza/profilet>.

Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve në financat publike vendore është një hapi rëndësishëm në vlerësimin e kapacitetit financiar të tyre në funksion të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjithashtu, një kuptim më i mirë i raportit kompetenca – burime financiare të disponueshme informon hartimin e politikave efektive dhe eficiente në qeverisjen vendore, lehtëson dialogun ndërmjet niveleve të qeverisjes, informon mbi kapacitetet huamarrëse, përmirëson llogaridhënien, transparencën dhe besimin e komunitetit në përfaqësuesit vendorë.

Status raporti i financave vendore ka për qëllim të paraqesë një panoramë të përgjithshme të financave publike vendore për 61 bashkitë, në fund të vitit 2018. Performanca financiare e bashkive në kahun e të ardhurave dhe në shpërndarjen e tyre në funksion të ofrimit të shërbimeve publike përbën një moment të rëndësishëm në fund të reformave decentralizuese të ndërmarra përgjatë katër viteve të fundit (RAT³, SNDQV 2015-2020, etj.) dhe në prag të zgjedhjeve vendore, në qershor të vitit 2019.

Në nivel të përgjithshëm, burimet financiare totale për bashkitë rezultojnë të kenë ndjekur prirje rritëse, ndikuar gjerësisht nga përmirësimi i shënuar në të ardhurat nga burimet e veta vendore dhe transfertat e pakushtëzuar dhe specifike. Në strukturën e të ardhurave nga burime të veta vendore, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe ajo e pronës janë dy kontribuesit kryesorë. Në prani të burimeve financiare të shtuara, bashkitë rritën shpenzimet e tyre nën efektin e zgjerimit të shpenzimeve korrente (personel dhe operative). Në të kundërt, shpenzimet për investime (me fonde të veta dhe të kushtëzuara) u tkurrën gjatë periudhës në analizë.

Status Raporti i Financave Publike Vendore për vitin 2018, paraqet në kapitullin e dytë një analizë të detajuar të ecurisë së burimeve financiare vendore sipas kategorive; në kapitullin e tretë trajtohen shpenzimet e kryera nga qeverisja vendore me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara, ndërthurur me natyrën ekonomike dhe funksionale të shpenzimeve. Në vijim, disa rezultate dhe rekomandime për të ardhmen.


BURIMET FINANCIARE

Katërvjeçari i fundit u karakterizua nga një intensitet i lartë i reformave në kuadrin e decentralizimit të qeverisjes nga niveli qendror në atë vendor. Nën këtë emërues të përbashkët u hodhën hapa të rëndësishëm të cilët u materializuan në: ri-organizimin administrativ dhe territorial në 61 bashki (dhe 12 qarqe); miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore 2015-2020 (SNDQV 2015-2020); hartimin dhe miratimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, i cili ndër të tjera transferoi në nivel ekskluziv një sërë funksionesh të reja; miratimin e ligjit të parë që rregullon financat vendore; si dhe një sërë aktesh të tjera nën-ligjore.

Objektiv i përbashkët i të gjitha ndërhyrjeve të sipërpërmendura ishte *fuqizimi i qeverisjes vendore për të krijuar kushtet për rritjen e kapaciteteve vendore në ofrimin cilësor të shërbimeve dhe rritjes së efciencës në administrimin e burimeve në dispozicion*. Zgjerimi i territoreve në administrim, rritja e numrit të popullsisë dhe shtimi i funksioneve në mënyrë simetrike ndërmjet 61 bashkive, përballi këto të fundit me sfida të rëndësishme në terma të paraqitjes të shërbimeve publike vendore, në prani të kufizimeve buxhetore.

Ndër treguesit e përdorur për të vlerësuar rëndësinë e qeverisë vendore në qeverisjen e përgjithshme është raporti i burimeve financiare ndaj PBB-së nominale. Të dhënat tregojnë se treguesit për të ardhurat për qeverisjen vendore (totale dhe përjashtuar transfertat e kushtëzuara) në raport ndaj PBB-së, pas një ecurie me luhajtje minimale gjatë viteve 2010-2015, në tre vitet në vijim kanë shënuar prirje rritëse diktuar nga faktorë të ndryshëm si, shtimi i funksioneve të reja dhe përgjegjësi për të shpenzuar, përdorimi i agjentëve tatimorë të UK-ve dhe ndryshimi i politikës fiskale të bashkive (rritja e taksave dhe tarifave vendore).

Grafik 1. Treguesit e të ardhurave ndaj PBB-së




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Me miratimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe transferimin e funksioneve të reja në vitin 2016, ato u shoqëruan me faturën financiare përkatëse, ose ndryshe me transfertën specifike për financimin e tyre. Në vitin pasardhës, u miratua Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i cili ndër të tjera përcaktoi dhe stabilizoi përmasën e transfertës së pakushtëzuar për qeverisjen vendore. Të dyja këto ndërhyrje krijuan mjete monetare shtesë, të cilat kontribuan në përmirësimin e treguesve ndaj PBB-së. Për pasojë në vitin 2018, burimet financiare totale në dispozicion të qeverisjes vendore përfaqësuan rreth 5% ndaj PBB-së. Përfshirë të hyrat nga transfertat e kushtëzuara, burimet financiare të disponueshme regjistruan një nivel prej rreth 3% të PBB-së nominale. Ndonëse në kahun përmirësues, të dy këto raporte qëndrojnë ndjeshëm nën mesataren e vendeve të Evropës Juglindore prej rreth 5.9% dhe vendeve të BE-së prej rreth 10.7% ndaj PBB-ve përkatëse⁴.

Në të njëjtën linjë me treguesit e lartpërmendur, treguesit e autonomisë fiskale vendore rezultojnë të jenë përmirësuar në fund të vitit 2018, në terma vjetorë dhe krahasuar me mesataren afatgjatë. Përmirësimi i treguesve të autonomisë vendore gjykohet të jetë ndikuar gjerësisht prej zgjerimit të të ardhurave nga burimet e veta vendore dhe transfertat e pakushtëzuar dhe specifike. Megjithatë, të dy treguesit qëndrojnë nën mesataren e vendeve të EJL: raporti i të ardhurave nga burimet e veta vendore/burimeve totale ishte 34.4% dhe raporti i burimeve të disponueshme / burimeve totale ishte rreth 72.9% për vendet e EJL⁵ versus 29.1% dhe 59.3% në rastin e Shqipërisë.

Grafik 2. Tregues të tërthortë të autonomisë fiskale vendore




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.1 Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore


Të ardhurat nga burimet e veta vendore janë thelbësore për një qeverisje vendore të mirë dhe të pavarur. Në buxhetin vendor, kjo kategori të ardhurash përfaqësoi rreth 29.1% ndaj burimeve financiare totale në vitin 2018. Krahasuar me një vit më parë, ky raport shënoi një përmirësim të lehtë me rreth 2.3 pikë përqindjeje dhe qëndron rreth 3.1 pikë përqindjeje mbi mesataren afatgjatë. ⁶ Në këtë përmirësim vlerësohet të kenë ndikuar një sërë faktorësh, si rritja e nivelit të taksave dhe tarifave vendore në disa prej bashkive dhe përmirësimi i mundshëm në normën e mbledhjes së të ardhurave (duke përdorur si agjentë tatimorë ndërmarrjet e UK-ve). Aktualisht, ky raport qëndron nën mesataren e vendeve të EJL (rreth 34.4% në vitin 2017). ⁷

Grafik 3. Rëndësia e të ardhurave nga burime të veta në buxhetin vendor



Në terma nominalë, në fund të vitit 2018 të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me asete dhe të tjera) regjistruan një vlerë prej rreth 24.2 miliard lekë, në rritje me rreth 19.1% në terma vjetorë, rreth 3.9 miliard lekë më të larta nga niveli i regjistruar vitin e mëparshëm.

Grafik 4. Peshja e të ardhurave nga burime vendore ndër vite




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Si planifikuan bashkitë për vitin 2018?⁸

Procesi i buxhetimit paraqet një hap të rëndësishëm për bashkitë në vend. Nga përpunimi i informacioneve të përfshira në dokumentet e Programeve Buxhetore Afatmesme (PBA-ve) dhe buxheteve vjetore, vlerësohet se bashkitë planifikuan të realizonin rreth 27.2 miliard lekë nga të ardhurat nga burimet e veta. Krahasuar me sa buxhetuar, të dhënat tregojnë për një realizim prej rreth 24.2 miliard lekë për vitin 2018, rreth 2.9 miliardë lekë më pak nga sa parashikuar, apo 10.9% më pak se plani. Në nivel bashkie, hendeku midis të ardhurave të planifikuara dhe atyre të realizuara është i qenësishëm dhe, në përgjithësi, bashkitë mbivlerësojnë parashikimet për nivelin e të ardhurave për vitin buxhetor. Në nivel bashkie:

- rreth 13.1% e bashkive (ose 8 nga 61 bashki) realizojnë më pak se 50% e të ardhurave të planifikuara;
- 29.5 % e bashkive (ose 18 nga 61 bashki) realizojnë 50% - 70% të të ardhurave të planifikuara;
- 49.2% e bashkive (ose 18 nga 61 bashki) realizojnë rreth 71-100% të të ardhurave të planifikuara;
- 8.2% e bashkive (ose 15 nga 61 bashki) realizojnë mbi 100% të të ardhurave të planifikuara.

Grafik 5. Planifikimi i të ardhurave vendore përkundrejt realizimit




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Devijimet e shënuara në realizim krahasimisht nga sa planifikuar, si negative ashtu dhe pozitive, vlerësohet të jenë problematike në terma të qëndrueshmërisë së financave publike në nivel vendor. Mos-realizimi dhe mbi-realizimi në nivelin e të ardhurave të veta nuk është i shëndetshëm, duke qenë se: (a) në rastin e nën-realizimit të të ardhurave mund të ketë ndikime dhe që mund të përkthehen në një nivel më të ulët shërbimesh apo investimesh të lakuara dhe angazhuar përballë komunitetit përgjatë fazës së përgatitjes së dokumentit të buxhetit vendor (vjetor dhe PBA-së); bashkitë mund të gjenden në kushtet e mungesës së likuiditetit për të përballuar pagesat e planifikuara dhe, për pasojë, mund të akumulojnë detyrime të papaguara (apo detyrime të prapambetura); dhe (b) mbi-realizimi apo tejkalimi i parashikimeve fillestare për nivelin e të ardhurave nga burimet e veta, gjithashtu, sinjalizon për parashikime të dobëta duke lënë hapësirë për rishikime buxheti apo kryerje shpenzimesh të paplanifikuara.

Sipas kategorive përbërëse, performanca pozitive e të ardhurave nga burime të veta është përcaktuar gjerësisht nga kontributi i të ardhurave nga tarifat vendore me rreth 10.0 pikë përqindjeje në fund të vitit 2018. Të ardhurat nga taksat vijnë të kontribuojnë pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave vendore, ndonëse kontributi i tyre u tkurr nga rreth 16.2 pikë përqindjeje në vitin 2017 dhe në rreth 8.8 pikë përqindjeje në vitin 2018. Ndryshimet në kontributin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në totalin e burimeve të veta, pasqyrojnë deri diku ndryshimet e aplikuara në politikën fiskale të bashkive.

Grafik 6. Kontributi sipas kategorive (në p.p.) në ndryshimin vjetor (në %)




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel të agreguar, roli i të ardhurave nga taksat vendore është zvogëluar nga viti në vit: në vitin 2010 pesha e të ardhurave nga taksat ndaj të ardhurave totale prej burimeve të veta vendore ishte rreth 71.1%, në vitin 2015 ishte rreth 63.9% dhe në vitin 2018 u tkurr në rreth 59.7% ndaj totalit. Ndërhyrjet e shpeshta në kuadrin legjislativ për ndryshimin e nivelit dhe bazës së taksueshme, apo përjashtimet për kategori të caktuara (si p.sh. në rastin e taksës mbi aktivitetin e biznesit të vogël/tatimi thjeshtuar mbi fitimin apo taksën e pronës, mungesa e një kadastrë fiskale apo dhe norma relativisht e ulët e mbledhjes së tyre), vlerësohet të kenë dobësuar rolin e këtij burimi të ardhurash në buxhetin vendor.

Roli i të ardhurave nga taksat, tarifat dhe burimet e tjera vendore në buxhetin vendor ndryshon ndjeshëm ndërmjet 61 bashkive në vend. Për rreth 45.9% të bashkive (28 nga 61 bashki) të ardhurat nga taksat përfaqësojnë mbi 50% të të ardhurave nga burimet e veta. Bashkitë Vlorë, Ura Vajgurore, Tiranë, Shijak, Roskovec, Lezhë, Kavajë dhe Durrës mbledhin të ardhura nga taksat vendore mbi mesataren kombëtare prej rreth 59.7%. Ndërsa, për rreth 50.8% të bashkive (31 nga 61 bashki) janë të ardhurat nga tarifat të cilat përfaqësojnë mbi 50% e këtyre nga burimet e veta vendore të bashkisë. Në bashkitë Bulqizë, Kamëz, Kukës, Kuçovë, Patos, Pukë dhe Skrapar tarifat vendore kontribuojnë me më shumë se 70% në të ardhurat nga burimet e veta vendore të bashkisë.

Kapaciteti i bashkive për të gjeneruar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore, gjithashtu, paraqet diferenca të theksuara ndërmjet bashkive (në linjë me karakteristikat në terma të popullsisë rezidente dhe bizneseve të lokalizuara në territor): rreth 61.8% e të ardhurave totale nga taksat vendore mblidhet në bashkinë Tiranë, ndjekur nga ajo Durrës me rreth 5.2%, nën efektin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Panoramë e ngjashme paraqitet edhe në rastin e të ardhurave nga tarifat vendore: bashkia Tiranë mbledh rreth 43.0% të totalit, ndjekur nga bashkitë Kamëz dhe Durrës me 5.8% dhe 4.7%, përkatësisht. Praktikiht, pesha e bashkive ndaj totalit të të ardhurave si nga taksat ashtu dhe nga tarifat vendore, sugjeron për një hendek të madh në terma të kapaciteteve fiskale ndërmjet bashkisë Tiranë dhe 60 bashkive të tjera. Përfshirë bashkinë Tiranë, diferencat mes bashkive vijnë të jenë të theksuara midis bashkive qendra qarku (bashkitë e mëdha) dhe 49 bashkive të tjera. Diferencat e theksuara midis bashkive në terma të kapaciteteve fiskale parashtrajnë nevojën për instrumente kompensues apo zbutës të tyre, për të lejuar përmbushjen e funksioneve apo ofrim të shërbimeve publike, në sasi dhe cilësi.

Grafik 7. Përbërja e të ardhurave nga burime të veta sipas bashkive




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.1.1 Të ardhurat nga taksat vendore

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm financiar në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore. Në vitin 2018, taksat vendore kontribuan me rreth 59.7% në të ardhurat nga burimet vendore, raport ky rreth 4.8 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (prej rreth 64.5%). Në terma nominalë, të ardhurat nga taksat vendore regjistruan një nivel prej rreth 14.5 miliard lekë, në rritje me rreth 14.1% në terma vjetorë.

Grafik 8. Ecuria e të ardhurave nga taksat vendore




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndonëse në terma të përgjithshëm të ardhurat nga taksat vendore rezultojnë të kenë shënuar zhvillime pozitive, një vështrim i hollësishëm mbi elementët përbërës evidenton dobësitë afatgjata apo varësinë ndaj një numri të kufizuar taksash. Në tre vitet e fundit, performanca e të ardhurave nga taksat vendore është përcaktuar nga dy elementë: taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe taksat mbi pasuritë e paluajtshme (ndërtesa, tokë bujqësore, truall). Ndërkohë që pesha e kësaj të fundit është tkurrur, pesha e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja është rritur me ritme të përshpejtuara. Në vitin 2018, këto dy lloje taksash përfaqësuan 81.6% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore. Në të kundërt, pesha dhe kontributi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël dhe taksat e tjera u tkurrën në vitin 2018.

Taksa mbi pasuritë e paluajtshme dhe transaksionet e kryera mbi to, përbën një burim të qenësishëm dhe të qëndrueshëm të ardhurash për buxhetin vendor. Në tre vitet e fundit, të ardhurat nga kjo taksë vlerësohen në rreth 0.3% ndaj PBB-së nominale, raport ky ndjeshëm më ulët krahasuar me mesataren e BE-së prej rreth 1.6% të PBB-së për vitin 2017 (NALAS 2019). Ndonëse ndër vite të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme kanë ndjekur përgjithësisht prirje rritëse, problematikat e lidhura me të drejtat e pronësisë dhe mungesës së regjistrave kadastrale, ndër të tjera, pengojnë shfrytëzimin e plotë të potencialit të kësaj takse. Në vijim të reformimit rrënjësor të kësaj takse nëpërmjet Ligjit nr. 106/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, 'Për sistemin e taksave vendore', të ndryshuar", fillim viti 2019 pritet të jetë dhe momenti kur të gjitha bashkitë në vend do të aplikojnë taksën e pronës sipas metodologjisë të re, bazuar në komunikimet në media të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë⁹.

Grafik 9. Të ardhurat nga taksat vendore sipas zërave kryesorë




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Bazuar në këtë metodologji, baza e taksueshme do të përbëhet nga vlera e tregut e ndërtesës përcaktuar sipas rregullave të vendosura nga qeveria qendrore. Niveli i taksës do të jetë 0.05% e vlerës së banesës për familjarët, dhe 0.2% e vlerës së ndërtesës në rastin e bizneseve.

Në fund të vitit 2018, të ardhurat nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme regjistruan një vlerë prej rreth 5.2 miliard lekë¹⁰, në rritje me rreth 10.6% krahasuar me vitin e mëparshëm. Të gjitha kategoritë përbërëse kontribuan pozitivisht në performancën e të ardhurave nga taksat mbi pasuritë e paluajtshme gjatë periudhës në analizë. Me informacionet në dispozicion, është vështirë të gjykohet nëse përmirësimi i performancës është përcaktuar nga zgjerimi, nga përmirësimi i normës së mbledhjes, zgjerimi i bazës, apo sa larg potencialit të të ardhurave nga kjo taksë ndodhen bashkitë. Në nivel bashkie, rreth 43.2% e të ardhurave nga taksat për pasuritë e paluajtshme realizohet në bashkinë Tiranë, rezultat i përqendrimit të një numri të lartë banesash dhe ndërtesash në këtë territor.


Grafik 10. Të ardhurat taksat mbi pasurinë e paluajtshme



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Bashkia Durrës renditet e dyta për nga pesha në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme me rreth 8.4% ndaj totalit për periudhën e konsideruar. Në terma kumulativë, bashkitë Durrës dhe Tiranë gjeneruan mbi 50% të të ardhurave nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme për vitin 2018.


Grafik 11. Të ardhurat taksa mbi pasurinë e paluajtshme (sipas bashkive)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në terma strukturorë, të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat zënë peshën më të madhe në totalin nga të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme (mesatarisht 73.6% në tre vitet e fundit). Për vitin 2018, të ardhurat nga kjo taksë regjistruan një nivel prej rreth 3.8 miliard lekë, në rritje me rreth 6.9% në terma vjetorë. Rreth 48.0% e të ardhurave totale nga taksa e ndërtesës u mbledh në bashkinë Tiranë ndjekur nga bashkitë Durrës (7.4% ndaj totalit) dhe Fier (4.1% ndaj totalit). Përdorimi si agjent tatimor i ndërmarrjeve të UK-ve duket të ketë dhënë rezultate pozitive në periudhën e konsideruar. Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore, ndonëse me peshë të moderuar, kontribuan me rreth 628.9 milionë lekë (në rritje me rreth 8% në terma vjetorë) në kategorinë e të ardhurave nga taksa mbi pronën.

Grafik 12. Të ardhura nga taksat mbi ndërtesën dhe tokën bujqësore




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në ndryshim nga elementi i përqendrimit të të ardhurave nga taksa e ndërtesës në një numër të kufizuar bashkive, të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore rezultojnë të jenë të shpërndara ndërmjet bashkive. Niveli më i lartë i kësaj takse u mbledh në bashkinë Fier (rreth 10.9% e totalit), ndjekur nga bashkitë Divjakë (5.1% e totalit), Roskovec (4.0%) dhe Ura Vajgurore (3.9%), lidhur dhe me karakterin bujqësor të ekonomive të këtyre bashkive.

Të hyrat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja vijojnë të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm dhe qenësishëm në buxhetin vendor: në vitin 2018 të ardhurat nga kjo taksë përfaqësuan rreth 49.9% ndaj totalit të të ardhurave nga taksat vendore dhe rreth 29.8% ndaj totalit të të ardhurave nga burimet e veta. Këta dy tregues sinjalizojnë për varësi të lartë të buxhetit vendor nga kjo taksë dhe rreziqe të shtuara varësisht natyrës ciklike të saj. Gjithashtu, mund të ndodhë që bashkitë të zhvendosin preferencat për likuiditet në terma afatshkurtër, në kurriz të zhvillimi të qëndrueshëm afatgjatë.

Grafik 13. Ecuria e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja vijuan të rriten me ritme dyshifrore për të tretin vit radhazi. Në vitin 2018, të ardhurat nga kjo taksë shënuan një nivel prej rreth 7.2 miliardë lekë, në rritje me rreth 39.4% në terma vjetorë, ose rreth 2.1 miliardë lekë më shumë krahasuar me vitin e mëparshëm. Performanca në të ardhurat prej kësaj takse sugjeron për vijimësi të presioneve zhvillimore (rritje e numrit të lejeve të ndërtimit nga bashkitë në vijim të miratimit të planeve të përgjithshme vendore nga rreth 819 leje të reja në vitin 2016 në rreth 1,194 leje të reja në vitin 2017), ndonëse ky presion është përqendruar kryesisht në bashkinë Tiranë. Zbatimi i Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV) nëpërmjet lejeve të reja të ndërtimit, nga një anë, ndikon pozitivisht në rritjen e të ardhurave nga TNI për bashkitë, nga ana tjetër, i vendos ato në një pozicion sfidues për ofrimin e infrastrukturave të nevojshme publike, të cilat gjithashtu kërkojnë financime si në zhvillim fillestar ashtu dhe në mirëmbajtje të vazhdueshme.

Në nivel mesatar, të ardhurat nga TNI (nga ndërtimet e reja dhe të ardhurat nga legalizimet) përfaqësuan rreth 49.9% të të ardhurave nga taksat vendore në vitin 2018, në rritje me rreth 9 pikë përqindjeje krahasuar me vlerën e këtij raporti në vitin e mëparshëm.


Grafik 14. TnJ, bashkitë ndaj mesatares kombëtare



Për rreth 9.8% të bashkive, të ardhurat nga kjo taksë qëndrojnë mbi mesataren kombëtare. Ndërkohë, në rreth 24.6% të bashkive të ardhurat nga kjo taksë përfaqësojnë më pak se 10% të të ardhurave nga taksat vendore duke reflektuar deri diku edhe presione më të ulëta zhvillimi.

Në vitin 2018, bashkia Tiranë arkëtoi rreth 5.5 miliardë lekë (në rritje me rreth 57.6% në terma vjetorë) ose rreth 75.6% të të ardhurave totale nga kjo taksë. Niveli i të ardhurave nga kjo taksë është në linjë me të dhënat mbi numrin e lejeve të ndërtimit (në vitin 2018 bashkia Tiranë rezultojnë të ketë dhënë rreth 79 leje më shumë se në vitin 2017).¹¹ Në të kundërt, bashkia Pustec rezultojnë të mos ketë gjeneruar të ardhura nga taksat e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2018. Në bashkinë Durrës, të ardhurat nga taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja rezultojnë të jetë tkurrur me rreth 40.1% në terma vjetorë (ndonëse, numri i lejeve të ndërtimit të dhëna rezultojnë të jetë në rritje). E njëjta prirje vërehet edhe në bashkinë Shkodër ku nga rreth 128.6 milionë lekë në vitin 2017, në vitin 2018 u mbledhën rreth 99.4 milionë lekë në vitin 2018. Në bashkinë Vlorë, të ardhurat nga kjo taksë rezultojnë të jenë thuajse pesë-fishuar gjatë periudhës së konsideruar.

Grafik 15. Taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (total = 100%)



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


Rritja e kontributit të kësaj takse në buxhetin vendor do të kërkonte njëkohësisht parashikime dhe angazhime afatmesme deri/dhe afatgjata në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike vendore për zhvillimet e reja. Gjithashtu, duke qenë një burim të ardhurash i fundëm dhe jo i vazhdueshëm, bashkitë duhet të gjejnë zgjidhje dhe të aftësohen për t'u bërë ballë detyrimeve financiare të sotme dhe atyre të ardhshme, përballë një buxheti të kufizuar – kjo do të krijonte kushte të favorshme dhe do të ishte në përputhje me konceptin e barazisë ndër-gjeneracionale. Praktikisht, të ardhurat e realizuara sot nga kjo taksë do të duhej të investoheshin për të siguruar infrastrukturën e nevojshme publike si dhe operimin e tyre në të ardhmen, pa rënduar në buxhetet e gjeneratave të ardhshme.

Të ardhurat nga *tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël* regjistruan një vlerë prej 329.5 milionë lekë në 2018, me një rritje të lehtë prej 5.9% krahasuar me vitin 2017. Në terma afatgjatë dhe në vijim të ndryshimeve të ndërmarra¹², të ardhurat nga kjo taksë vijnë të ulin në mënyrë progresive kontributin e tyre në totalin e të ardhurave nga burime të veta vendore.

Me ndryshimet legjislative të ndërmarra në vitin 2016, qeverisja vendore humbi një prej instrumenteve për të tërhequr dhe nxitur krijimin e ndërmarrjeve të reja në territoret në administrim.

Ndonëse në masë më të ulët, të ardhurat nga taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier kontribuoi pozitivisht në rritjen e përgjithshme të të ardhurave nga taksat vendore. Për vitin 2018, të ardhurat nga kjo taksë shënuan një nivel prej rreth 214.1 milionë lekë, në rritje me rreth 17% në terma vjetorë.

Grafik 16. Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Për vitin 2018, rreth 44.6% e të ardhurave nga taksa e hotelit u mbledhën në bashkinë Tiranë, ndjekur nga bashkia Sarandë me rreth 11.6% të të ardhurave totale. Ndërkohë, niveli i të ardhurave të mbledhura nga bashkitë e tjera me potencial turistik rezultojnë të jetë relativisht i ulët. Kjo mund të sinjalizojë për probleme strukturore në lidhje me regjistrimin e strukturave akomoduese dhe raportimin e numrit të pushuesve.

2.1.2 Të ardhurat nga tarifat vendore

Të ardhurat nga tarifat vendore përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të hyrash në buxhetin vendor. Ndaj totalit të të ardhurave vendore, të ardhurat nga tarifat zënë një peshë prej 39.7% dhe përfaqësojnë një kategori të ardhurash mbi të cilat bashkitë kanë të drejta të plota. Në përgjithësi, të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin prirje rritëse nga viti në vit, diktuar deri diku edhe nga performanca e një grupi bashkish të cilat kanë aplikuar rritje të nivelit të tarifave vendore si dhe përdorimi i UK-ve si agjentë tatimorë. Gjatë vitit 2018, ecuria e të ardhurave nga tarifat vendore kontribuoi pozitivisht në ecurinë totale të të ardhurave nga burimet e veta të bashkive duke regjistruar një nivel prej rreth 9.6 miliard lekë, në rritje me rreth 26.9% në terma vjetorë.

Grafik 17. Performanca e zërave kryesorë të tarifave vendore



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike (menaxhimi i mbetjeve, ndriçimi dhe gjelbërimi, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, ujitja dhe kullimi) regjistruan një vlerë prej rreth 4.5 miliardë lekë, në rritje me rreth 26.1% në terma vjetorë. Rreth 88.2% e të ardhurave nga tarifat për shërbimet publike u mblodhën nga tarifa e pastrimit dhe higjienës (dhe rreth 50% e tyre në bashkinë Tiranë). Të ardhurat nga tarifa e ndriçimit publik regjistruan një nivel prej rreth 283.9 milionë lekë duke përfaqësuar rreth 6.3% ndaj totalit nga tarifat e shërbimeve publike.

Tabelë 1. Të ardhura nga tarifa vendore sipas kategorive (në lekë)

	Në vlerë	Pesha ndaj totalit
Tarifë pastrimi dhe higjienë	3,989,297,718	88.20%
Tarifa për ndriçimin publik	283,882,567	6.30%
Tarifa për gjelbërimin	244,937,700	5.40%
Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizimet	183,808	0.00%
Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	3,360,123	0.10%
Të ardhura nga tarifat e shërbimeve	4,521,661,916	100.00%

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të ardhurat nga tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit regjistroan shifra relativisht modeste dhe janë grumbulluar nga bashkitë Elbasan, Lezhë, Roskovec, Divjakë dhe Lushnjë. Paraprakisht, mund të thuhet se ka marzhe përmirësimi të mbledhjes së kësaj tarife, sidomos në ato bashki ku toka bujqësore nën juridiksion ka nevojë për shërbime të ujitjes dhe kullimit.

Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave gjithashtu ka pësuar një rritje të konsiderueshme në periudhën në analizë duke shënuar një vlerë prej 1.3 miliardë lekë në 2018, nga 640 milionë lekë të mbledhura në 2017. Nëse do të shikonim performancën e zërave specifike, rezulton se të ardhurat nga tarifa për zënien e hapësirës publike për qëllime biznesi (bare dhe restorante) zënë peshën më të lartë me rreth 52.0% të totalit, ndjekur nga të ardhurat nga tarifa për parkingjet me rreth 40.2% të totalit. Lidhur me të ardhurat nga tarifa për parkingjet, vlen për t'u përmendur fakti se vetëm bashkia Tiranë mbledh rreth 83.6% të të ardhurave totale nga kjo tarifë. Në këtë drejtim, bashkitë e tjera të mëdha, qendra qarku, nuk kanë patur të njëjtën performancë, ndonëse kanë potencial (duke konsideruar numrin e popullsisë dhe të automjeteve).

2.1.3 Huamarrja vendore dhe detyrimet e prapambetura

Në mungesë apo prani të mjeteve financiare të pamjaftueshme, ligjërisht bashkitë në vend mund të marrin hua afatshkurtër me qëllim mbulimin e nevojave për likuiditet afatshkurtër ose afatgjatë me qëllim financimin e shpenzimeve kapitale apo rifinancimin e një huaje ekzistuese. Termat dhe kushtet për të aksesuar hua nga qeverisja vendore në Shqipëri janë specifikisht të rregulluara në Ligjin nr. 9869/2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”. Bazuar në të dhënat e publikuara në regjistrin e borxhit në fund të vitit 2018, rezulton se bashkitë Korçë, Pogradec, Vlorë, Elbasan, Lezhë dhe ish-komuna Petrelë kanë përfituar hua. Të gjitha huatë e lartpërmendura janë kontraktuar në vitin 2010 dhe vitin 2014, me qëllim financimin e projekteve infrastrukturore. Pas vitit 2014, asnjë bashki nuk rezulton të ketë marrë hua.


Tabelë 2. Borxhi i bashkive

Huamarrësi	Huadhënësi	Shuma (në milionë lNënskruar më:	Përfundon më:	Stoku në fund të vitit 2018:	
Bashkia Korçë	Pro Credit	100	2010	2020	27.58
Bashkia Korçë	ISBA	200	2014	2024	143.26
Bashkia Pogradec	Pro Credit	113	2010	2020	9.83
Bashkia Vlorë	BKT	420	2010	2020	50.21
Kom. Petrelë	BKT	15	2010	2019	0.28
Bashkia Elbasan	BKT	800	2010	2020	436.32
Bashkia Lezhë	ISBA	107	2014	2023	48.19

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Regjistri i Borxhit 2018T4)¹³

Në total, stoku i borxhit të qeverisjes vendore në fund të vitit 2018 rezulton të jetë rreth 715.7 milionë lekë ose rreth 0.043% ndaj PBB-së¹⁴ dhe jep një kontribut marzhinal në shifrën e borxhit publik të përgjithshëm. Pas vitit 2014, asnjë nga bashkitë e reja nuk rezulton të ketë marrë hua të reja, pavarësisht nevojave të theksuara për investime, të cilat në bashkitë e mëdha duket të jenë adresuar nëpërmjet përdorimit të skemave të PPP-ve. Trajektorja e konsolidimit fiskal të ndërmarrë nga MFE, duket të ketë kufizuar hapësirën për huamarrje të re për bashkitë, për sa kohë borxhi vendor rrit nivelin e përgjithshëm të borxhit publik.

Grafik 18. Borxhi publik përkundrejt kriterit të Mastrokit




Burimi: INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe përpunime të autorëve

Ndërkohë, krahas treguesve të borxhit, bashkitë në vend mbartin ndër vite stokun e detyrimeve të prapambetura, të cilat në fund të vitit 2018 u vlerësuan në rreth 6.8 miliardë lekë, 9.5 herë më i lartë se stoku i borxhit të qeverisjes vendore. Në raport ndaj PBB-së, detyrimet e prapambetura përfaqësojnë rreth 0.41%. Mesatarisht, detyrimet e prapambetura të bashkive rëndojnë qytetarët për rreth 2,418 lekë për frymë. Në nivel bashkie, detyrimet e prapambetura për frymë¹⁵ shënojnë vlerën maksimale në bashkinë Konispol me rreth 13,755 lekë për frymë dhe vlerën minimale në bashkinë Maliq me rreth 57 lekë për frymë.

Detyrimet e prapambetura: sa rëndojnë në buxhetet e bashkive?

Detyrimet e prapambetura të bashkive u evidentuan në mënyrë sistematike duke filluar prej vitit 2015 në vijim të miratimit të VKM nr. 50/2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimit” dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5/2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në fund të vitit 2015, stoku i detyrimeve të prapambetura ishte rreth 11.8 miliardë lekë, vlerë kjo shqetësuese si në nivel vendor ashtu dhe në nivel qendror. Shlyerja u këtyre detyrimeve, pjesërisht të krijuara nga ish-komunat që iu bashkëngjiten bashkive të reja në vijim të reformës administrative dhe territoriale përbën barrë të qenësishme për buxhetet vendore. Në këtë kuadër, qeveria qendrore merr përsipër vetëm “shlyerjen e detyrimeve për punimet e kryera, por të papaguara në kuadër të financimeve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, si edhe transfertat për përfitimet e paaftësisë. Të gjitha detyrimet e tjera financiare të njëjësive të qeverisjes vendore, që nuk përfshihen në sa më sipër, duhet të parashikohen në vetë buxhetet e njëjësive të qeverisjes vendore.”

Në total, stoku i detyrimeve deri në fund të vitit 2018 shënoi rreth 6.8 miliardë lekë. Krahasuar



Grafik 19. Stoku i detyrimeve të prapambetura, dhjetor 2018

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


me stokun e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2017, stoku aktual rezulton të jetë ngushtuar me rreth 2.4 miliardë lekë, ose me rreth 26.9%. Kontributin kryesor në tkurrjen e detyrimeve të prapambetura e dhanë bashkitë Tiranë, Selenicë, Korçë dhe Prenjas. Në të kundërt, rreth 54.1% e bashkive (ose rreth 34 bashki) rezultojnë të kenë rritur stokun e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2018 krahasuar me nivelin e tij në fund të vitit 2017. Rritje e qenësishme vihet re në bashkitë Kamëz, Dibër, Bulqizë Mat, Mirditë, dhe Ura Vajgurore. Në nivel bashkie, rreth 68.3% e stokut të detyrimeve të prapambetura mbartet nga 10 bashki. Nivelin maksimal të detyrimeve të prapambetura e ka bashkia Tiranë me rreth 2.0 miliardë lekë, ose 29.5% ndaj stokut total në fund të vitit 2018. Bashkia Pogradec renditet e dyta për nga niveli i detyrimeve të prapambetura, me rreth 417.4 milionë lekë, ose rreth 6.2% ndaj totalit. Në të kundërt, bashkitë Këlcyrë dhe Shijak kanë stokun më të ulët të detyrimeve të prapambetura për periudhën e konsideruar.

2.2 Të ardhurat nga taksat e ndara

Me miratimin e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, u rishikuan dhe shtuan kategoritë e taksave të ndara ndërmjet qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Kështu, bashkitë përftojnë: (i) 97% e të ardhurave nga taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme për individë, persona fizikë dhe juridikë¹⁶ ; (ii) 25% të të ardhurave nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura; (iii) 5% të të ardhurave nga renta minerare; dhe (iv) 2% të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale. Të ardhurat nga kjo taksë nuk rezultojnë të jenë shpërndarë për bashkitë gjatë vitit 2018. Me një llogari të thjeshtë, kjo materializohet në një mungesë të ardhurash për buxhetet vendore prej rreth 642.1 milionë lekë¹⁷, të cilat do të duhet të ndaheshin ndërmjet bashkive sipas origjinës së tyre bazuar në parashikimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Ecuria në kohë e të ardhurave nga taksat e ndara ka qenë e luhatshme dhe pesha e këtij zëri ndaj të ardhurave nga burimet e veta shënoi një nivel prej rreth 6.0% në vitin 2018. Në tërësi, të ardhurat nga taksat e ndara kontribuan në buxhetin vendor me rreth 1.5 miliardë lekë në fund të vitit 2018, në rritje me rreth 18.5% në terma vjetorë.

Grafik 20. Të ardhura nga taksat e ndara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


2.3 Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike

Përmirësimi i vazhdueshëm i mirëqeverisjes vendore si dhe pajisja me shërbimeve publike vendore me eficiencë dhe efikasitet përbëjnë elementë thelbësorë për të ndikuar dhe nxitur zhvillimin ekonomik në territorin në administrim. Ushtrimi i funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” paraqet nevoja të reja për burime financiare, përballë kërkesave në rritje të komuniteteve të përfaqësuara. Transferta e pakushtëzuar përbën një burim financiar thelbësor në përmbushje të funksioneve ekskluzive të bashkive, duke synuar mbylljen e hendekut negativ midis nevojës për shpenzime dhe kapacitetit fiskal. Në vijim të transferimit simetrik në titull ekskluziv të një sërë funksionesh në vitin 2016, ushtrimi i tyre u realizua nëpërmjet mjeteve monetare të transferuara nga qeveria qendrore drejt asaj vendore, nëpërmjet transfertës specifike. Në përmbyllje të fazës tranzitore të transferimit të këtyre funksioneve apo duke filluar nga fillim viti 2019, ato do të financohen nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale të cilat do të përdoren në autonomi.¹⁸ Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” sanksionoi përmasën dhe mënyrën e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar: për çdo vit buxhetor, ajo është jo më pak se 1% e PBB-së sipas parashikimeve dhe vlerësimeve makroekonomike të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe, në çdo rast, nuk mund të jetë më e vogël se shuma totale e ndarë në vitin e mëparshëm; ndarja e saj bëhet nëpërmjet formulës së miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në vitin 2018, bashkitë përftuan rreth 23.6 miliardë lekë në total në trajtën e transfertës së pakushtëzuar (së bashku me transfertën specifike), në rritje me rreth 7.5% krahasuar me vitin e mëparshëm. Norma e rritjes së transfertës së pakushtëzuar dhe specifike duket të jetë moderuar në mënyrë progresive nga viti 2016 në vitin 2018, si pasojë e shuarjes së efektit bazë të rritjes nga transferta specifike.

Ndërkohë, për vitin 2019, të hyrat nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale pritet të jenë rreth 24.5 miliardë lekë, rreth 3.8% më e lartë krahasuar me vitin 2018. Në buxhetet vendore, rreth 15.5 miliardë lekë do të alokohen në trajtën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe rreth 8.8 miliardë lekë në trajtën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale (për funksionet e reja të transferuara në vitin 2016).

Grafik 21. Ecuria e transfertës së pakushtëzuar ndër vite




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Transferta e pakushtëzuar dhe specifike përbën burimin financiar kryesor për bashkitë duke përfaqësuar mesatarisht 47.9% të burimeve financiare të disponueshme. Rëndësia e këtij burimi bëhet më e dukshme në nivel bashkie, ku në rreth 83.6% të bashkive (ose 51 prej tyre) pesha e të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike rezulton mbi mesataren kombëtare për vitin 2018. Në bashkinë Pustec, 97% e të ardhurave vendore përfaqësohet nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike. Në të kundërt, pesha minimale ndaj burimeve financiare të disponueshme u regjistrua në bashkinë Tiranë, me rreth 18.8%.

Grafik 22. Varësia nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike, viti 2018




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.4 Të ardhurat nga transferta e kushtëzuar

Bazuar në nenin 27, të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, transfertat e kushtëzuara jepen për ushtrimin e funksioneve të deleguara dhe për projekte të veçanta (të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar) ku kërkohet bashkëpunimi i njësive vendore. Nisur nga sa specifikuar në ligj, fondet e kushtëzuara të transferuara në bashki përfshijnë jo vetëm fondet për ushtrimin e funksione të deleguara, por në to mund të kanalizohen edhe fondet për investime (përfshirë këtu dhe FZHR). Ndonëse nuk ushtrojnë kontroll mbi destinacionin e tyre, të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara përfaqësojnë rreth 40.7% ndaj totalit të burimeve financiare të bashkive në vitin 2018. Pesha e këtyre transfertave ndaj totalit të burimeve financiare është tkurrur gjatë periudhës së konsideruar, nga një nivel mesatar prej rreth 50% në periudhën 2010-2014 në nivelin mesatar prej 41.7% në tre vitet e fundit. Gjatë vitit 2018, qeverisja qendrore u transferoi bashkive rreth 33.9 miliardë lekë në trajtën e transfertës së kushtëzuar, në rritje me rreth 4.8% në terma vjetorë.

Gjatë vitit 2018, fondet e transferuara nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale¹⁹ shënuan një nivel prej rreth 21.1 miliardë lekë, në rënie të lehtë me rreth 0.9% krahasuar me vitin e mëparshëm. Këto fonde u transferohen bashkive në trajtën e transfertës së kushtëzuar për ndihmën ekonomike dhe pagesën e paaftësisë, dhe më tej bashkitë bëjnë shpërndarjen e tyre në përfituesit fundorë. Gjatë këtij viti, evidentohet një rritje substanciale e fondeve të kanalizuar në nivel vendor nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për transportin dhe infrastrukturën e cila transferoi rreth 2.8 miliardë lekë, në rritje me rreth 67.9% në terma vjetorë. Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban transferoi rreth 6.5 miliardë lekë në nivel bashkie (+6.4% krahasuar me vitin e mëparshëm), të cilat janë alokuar më së shumti në përmirësimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe zhvillimit të komunitetit (FZHR). Ministria përgjegjëse për arsimin, sportin dhe rininë alokoi në nivel vendor rreth 2.4 miliardë lekë në vitin 2018, nga të cilat rreth 2.2 miliardë lekë vlerësohet të jenë shpenzuar në investime për përmirësimin e infrastrukturës arsimore.

Grafik 23. Të ardhura nga transfertat e kushtëzuara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

2.5 Burime financiare totale


Ky seksion synon të pasqyrojë nga burojnë fondet me të cilat bashkitë ushtrojnë funksionet dhe përgjegjësitë, ofrojnë shërbime për komunitetin përkatës, si dhe performancën e tyre në fund të vitit 2018 (të dhëna kumulative)²⁰. Burimet financiare totale të qeverisjes vendore regjistruan një vlerë prej 83.1 miliardë lekë²¹ në fund të vitit 2018, në rritje me rreth 9.7% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nëse nga totali i burimeve financiare do të përjashtonin ato kategori të konsideruara me destinacion (transferta të kushtëzuara), të ardhurat mbi të cilat bashkitë ushtrojnë autoritet dhe kanë të drejta vendimmarrjeje shënuan një vlerë prej rreth **49.3 miliardë lekë**, në rritje me rreth 13.3% në terma vjetorë.

Burimet financiare mbi të cilat bashkitë kanë liri relative përdorimi në fund të vitit 2018 përfaqësuan rreth 59.3% të burimeve financiare totale dhe përfshijnë: të ardhurat nga burimet e veta, të ardhura nga transfera e pakushtëzuar dhe specifike²² dhe të ardhurat nga taksa të ndara. Në të kundërt, burimet financiare të kushtëzuara, përfaqësuan rreth 40.7% ndaj totalit, rreth 7.6 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (llogaritur si mesatare e peshës së kësaj kategorie ndaj totalit për periudhat e referuara).

Tabëlë 3. Burime financiare sipas kateorive (në lekë)

	Të ardhura nga burime të veta	Transferta e pakushtëzuar dhe specifike	Taksa të ndara	Transferta të kushtëzuara	Burime financiare totale
2010	12891663200	10561625060	1170003470	25806764310	50430056040
2011	12631701000	10204712000	1308927130	23412459060	47557799190
2012	11988290560	9229560860	1406942040	22726329460	45351122920
2013	12153488880	10955191220	1509291620	25177716670	49795688390
2014	14409383700	12128442390	1065198190	28582275720	56185300000
2015	13056130410	11251989590	1132951570	26356041130	51797112700
2016	16782224630	18146533940	1047236690	25628574190	61604569450
2017	20336808369	21917678257	1227289116	32308267287	75790043029
2018	24226073264	23569999546	1454075925	33860310617	83110459352


Grafik 24. Burimet financiare totale



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ecuria e burimeve financiare totale në fund të vitit 2018 u përcaktua prej ecurisë së të hyrave nga burimet e veta vendore, të cilat kontribuan me rreth 5.1 pikë përqindjeje në rritjen vjetore të burimeve financiare. Në të njëjtin drejtim, edhe pse në masë më të vogël (2.2 pikë përqindje), kontribuan edhe të hyrat nga transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike.

Grafik 25. Kontributi i kategorive (në pikë përqindje) në ndryshimin vjetor të burimeve financiare (në përqindje)




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Tregues të autonomisë financiare vendore.

Struktura e burimeve të financimit për bashkitë mund të përdoret si një tregues i tërthortë për të vlerësuar kapacitetin financiar të tyre, mundësinë për të ndërmarrë investime në mënyrë të pavarur dhe për të përmbushur kërkesat e komunitetit për shërbime publike. Mesatarisht, për 61 bashkitë në vend, të ardhurat nga burimet e veta përfaqësuan rreth 29.1% ndaj burimeve totale, të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike rreth 28.4% dhe të ardhurat nga taksat e ndara rreth 1.7% ndaj burimeve të financimit totale në fund të vitit 2018.

Në nivel bashkie, peshat që zënë të ardhurat e veta (taksa, tarifa dhe të tjera) në totalin e burimeve të financimit luhet në një interval të gjerë vlerash: vlera minimale u regjistrua në bashkinë Pustec me 1.8% dhe vlera maksimale në bashkinë Tiranë me rreth 60.6%. Në përpjesëtim të zhdrejtë, aty ku të ardhurat nga burimet vendore janë të ulëta, të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike financojnë gjerësisht buxhetin e bashkisë. Historikisht, transfertat e kushtëzuara kanë përfaqësuar nivelin më të lartë të të hyrave në buxhetet vendore dhe për vitin 2018 ato u vlerësuan në rreth 40.7% ndaj totalit të burimeve financiare. Një panoramë e përgjithshme mbi burimet e financimit të bashkive vijon të evidentojë diferenca të theksuara ndërmjet tyre edhe bazuar në të dhënat me bazë vjetore për 2018.

Grafik 26. Burimet financiare sipas bashkive




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

SHPENZIMET VENDORE

Përdorimi i burimeve financiare në dispozicion, përbën anën tjetër të rëndësishme në menaxhimin financiar publik vendor. Shpenzimet e qeverisjes vendore përfaqësojnë rreth 17.3% të shpenzimeve totale të qeverisjes së përgjithshme në vitin 2018. Deri në vitin 2015 ky raport nuk paraqet ndryshime të ndjeshme, duke u stabilizuar në një nivel mesatar prej rreth 13.7%. Në tre vitet e fundit, ky raport u përmirësua nga 15.9% në vitin 2016 në rreth 17.3% në vitin 2018, si pasojë e rritjes së burimeve financiare totale të bashkive.

Mesatarisht, në Shqipëri qeverisja vendore kanalizon mbi 70% të burimeve financiare totale për mbulimin e shpenzimeve korrente dhe rreth 30% për shpenzime kapitale. Shpenzimet kapitale të kryera nga qeverisja vendore përfaqësojnë rreth 1.4% ndaj PBB-së nominale në vitin 2018, raport ky në rënie me rreth 0.3 pikë përqindjeje krahasuar me nivelin e tij në vitin e mëparshëm.


Grafik 27. Investimet ndaj PBB-së



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve të ushtruara nga qeverisja (vendore apo qendrore) tregon sesi qeverisja vendore dhe ajo qendrore ndajnë mes tyre ushtrimin e funksioneve dhe të kompetencave (matur nga përçindja e shpenzimeve të kryera nga secili nivel i qeverisjes sipas funksioneve (sipas klasifikimit COFOG). Duke përjashtuar mbrojtjen si një funksion i ushtruar ekskluzivisht në nivel qendror, në funksionet e tjera pesha e qeverisjes vendore rezulton ndjeshëm më e ulët se ajo e qeverisjes qendrore. Bashkitë ushtrojnë kompetenca më të zgjeruara në funksionin e strehimit dhe komoditeteve të komunitetit (rreth 54.2% e shpenzimeve kryhet nga qeverisja vendore) dhe në funksionin e argëtimit, kulturës dhe çështjeve fetare (rreth 34.8% e shpenzimeve kryhet nga qeverisja vendore).

Grafik 28. Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksioneve



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


3.1 Shpenzimet sipas burimit të financimit

Analiza e shpenzimeve mundohet të paraqesë një panoramë të përgjithshme mbi mënyrën si janë shpenzuar paratë në dispozicion të bashkive në fund të vitit 2018: sipas burimit të financimit dhe kryqëzuar me kategorizimin sipas natyrës ekonomike (paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) dhe sipas funksioneve të qeverisjes (arsim, çështje ekonomike, mbrojtje mjedisi, etj.).

Në fund të vitit 2018, mjetet financiare të kanalizuar nga 61 bashkitë në vend, regjistruan një vlerë prej rreth 82.1 miliardë lekë, shifër kjo rreth 2.4% më e lartë se ajo e regjistruar në vitin e shkuar²³. Përbërës shpenzimet e kryera me fonde të trashëguara nga viti i mëparshëm, rezultojnë se bashkitë kanë alokuar në këtë vit rreth 80.6 miliardë lekë, rreth 7.3% më shumë se një vit më parë.

Shpenzimet me fondet e veta të bashkive regjistruan një nivel prej rreth **48.3 miliardë lekë** në fund të vitit 2018, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin e mëparshëm. Shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara shënuan një vlerë prej rreth 33.9 miliardë lekë, në rritje me rreth 4.7 miliardë lekë në terma vjetorë. Në terma strukturorë, rreth 58.8% e shpenzimeve u krye me fonde të veta, ndërsa 41.2% e tyre me fonde të kushtëzuara.


Grafik 29. Shpenzimet vendore sipas burimit të financimit



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Mesatarisht në tre vitet e fundit shpenzimet korrente janë mbuluar në masën 57% me fonde nga burimet e veta vendore dhe për rreth 43% nga burimet financiare të kushtëzuara. Në të njëjtën mënyrë, shpenzimet kapitale u mbuluan mesatarisht në masën 69% nga burimet e veta vendore dhe në masën 31% nga burimet e kushtëzuara. Në fund të vitit 2018, shpenzimet kapitale u mbuluan në masën 56% nga burimet financiare vendore dhe për rreth 43% nga ato të kushtëzuara (përfshirë këtu fondet nga FZHR).


Grafik 30. Mbulimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale sipas burimit



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Kryqëzimi i të dhënave sipas burimit të financimit dhe klasifikimit funksional tregon se, funksioni i mbrojtjes sociale mbulohet gjerësisht me fonde të kushtëzuara (transferta e kushtëzuar nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale). Në periudhën e konsideruar, rreth 89.4% e mbrojtjes sociale u financua me transferta të kushtëzuara. Në të kundërt, bashkitë mbulojnë me fonde të veta rreth 99.5% të shpenzimeve në funksionin e “çështjeve ekonomike”. Në fushën e strehimit dhe komoditeteve të komunitetit, rreth 44.6% e shpenzimeve u financua me fonde të kushtëzuara. “Rendi dhe siguria publike”, “Mbrojtja e mjedisit” dhe “Argëtimi, kultura dhe çështjet fetare” janë funksione kostot e të cilave mbuloheh nga fondet e veta të bashkive (ndonëse në vlera të nominale të ulëta).

Grafik 31. Shpenzimet sipas klasifikimit funksional dhe burimit të financimit




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.2 Shpenzimet e kryera me fonde nga burimet vendore

Në fund të vitit 2018, shpenzimet e kryera me fonde të veta të bashkive regjistruan një nivel prej rreth 48.3 miliardë lekësh, në rritje të lehtë me rreth 0.9% krahasuar me vitin e mëparshëm. Norma e rritjes së shpenzimeve, ngjashëm me atë të të ardhurave nga burimet e veta vendore, rezulton të jetë moderuar ndjeshëm pas përshejtimit të shënuar në vitin 2016 (deri diku efekti bazë i vitit të mëparshëm). Bazuar në kuadrin rregullativ në fuqi, "kursimet" në shpenzime të bashkive reflektohen në buxhetin e vitit pasardhës në trajtën e fondeve të trashëguara.

Grafik 32. Ritmi i rritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve me fonde të veta



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al


3.2.1 Shpenzime me fonde të veta sipas klasifikimit ekonomik

Shpenzimet korrente shënuan një nivel prej rreth 35.2 miliardë lekë në fund të vitit 2018, në rritje me rreth 17.2% në terma vjetorë. Kahu i zhvillimeve në shpenzimet e me fonde të veta përgjatë tre viteve të fundit është përcaktuar gjerësisht nga ecuria e shpenzimeve korrente. Në vitin 2018, zgjerimi i shpenzimeve korrente përbënte përcaktuesin kryesor në normën e rritjes me 0.9% të shpenzimeve me fonde të veta. Në të kundërt, ecuria e shpenzimeve kapitale me fonde të veta kontribuoi negativisht në ecurinë e shpenzimeve totale.

Ndër përbërësit e shpenzimeve korrente, *shpenzimet për personelin* (paga dhe sigurime) përbënë rreth 20.5 miliardë lekë gjatë periudhës së konsideruar, në rritje me rreth 8.5% krahasuar me vitin 2017. Shpenzimet për personelin vijojnë të ndjekin prirje rritëse vjetore, ndonëse me ritme më të moderuara ndikuar dhe nga shuarja e efektit të rritjes së numrit të punonjësve si pasojë e transferimit të funksioneve të reja. Kështu, në vijim të rritjes me rreth 53.4% në vitin 2016 (në vijim të transferimit të funksioneve të reja)²⁴, norma e rritjes u moderua në mënyrë progresive në 21.2% në vitin 2017 dhe në rreth 8.5% në vitin në analizë.

Shpenzimet operative dhe të tjera²⁵ regjistruan një nivel prej rreth 14.7 miliardë lekësh në fund të vitit 2018, me një rritje prej 32.0% krahasuar me një vit më parë. Në nivel të detajuar, shpenzimet operative të kryera me fonde të veta për këtë periudhë shënuan një vlerë prej rreth 13.4 miliardë lekësh, në rritje me rreth 32.9% në terma vjetorë.

Grafik 33. Kontributi sipas kategorive në shpenzimet me fonde të veta




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Të gjitha kategoritë e shpenzimeve operative rezultojnë të jenë zgjeruar gjatë vitit 2018: shpenzimet për materiale zyre (+31.3%); shërbime nga të tretët (+24.5%); shpenzime transporti (+24.8%); shpenzime udhëtimi (12.1%); shpenzime të tjera operative (+46.2%); dhe mirëmbajtje e zakonshme (+49.3%). Duke filluar prej vitit 2015, ecuria e shpenzimeve operative qartësisht po ndjek një trajektore rritëse, ku fundi i vitit 2018 shënoi nivelin maksimal të tyre. Ndonëse, rritja e shpenzimeve në këtë kategori rezulton të jetë e shpërndarë në thuajse të gjithë nën-zërat përbërës, ecuria e tyre në terma afatmesëm dhe afatgjatë duhet monitoruar me kujdes pasi mund të krijojë probleme qëndrueshmërie financiare për bashkitë.

Shpenzimet për *transferta për buxhetet familjare dhe individët* gjithashtu janë një zë i rëndësishëm në totalin e shpenzimeve me fonde të veta të bashkive. Për vitin 2018, kjo kategori shpenzimesh shënoi një vlerë prej rreth 1 miliard lekësh, në rritje me rreth 33.1% në terma vjetorë.

Grafik 34. Shpenzimet me fonde të veta sipas natyrës ekonomike




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet kapitale ose investimet, përbëjnë një zë të rëndësishëm të buxheteve vendore dhe një parakusht për zhvillim ekonomik afatgjatë. Ndër vite, niveli i shpenzimeve kapitale ka qenë i luhatshëm, edhe pse paraqet një korrelacion të mirë me ecurinë e burimeve financiare të veta të bashkisë, veçanërisht me të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja. Pas rritjes së përsheptuar në vitin 2017, shpenzimet për investime shënuan një vlerë prej rreth 13.1 miliardë lekësh në fund të vitit 2018, në rënie me rreth 26.7% në terma vjetorë.

Sipas funksioneve të qeverisjes, shpenzimet kapitale për funksionet “çështjet ekonomike” (ku përfshihet infrastruktura e transportit) dhe “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” (ku përfshihen shpenzimet për strehimin dhe urbanistikë, ujësjellës dhe kanalizime vendore, ndriçimi publik) zënë peshën kryesore të shpenzimeve kapitale në të gjitha periudhat e marra në analizë (50.1% dhe 25.7% respektivisht). Megjithatë, në vitin 2018 shpenzimet për investime në funksionin e “çështjeve ekonomike” u përgjysmuan në vitin 2018 duke regjistruar një nivel prej uljeje me rreth 6.6 miliardë lekësh nga rreth 13.0 miliardë lekë në vitin 2017 (në rënie vjetore me rreth 49.4%).


Grafik 35. Shpenzimet operative sipas zërave



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ndërkohë, investimet në funksionin “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” kanë pësuar një rritje të konsiderueshme me rreth 37.7% në terma vjetorë. Me transferimin e kompetencave të reja në lidhje me arsimin parashkollor dhe atë para-universitar, bashkitë kanë rritur nivelin e investimeve në infrastrukturën arsimore. Përkatësisht, investimet në arsim në vitin 2018 regjistruan një nivel prej rreth 1.3 miliardë lekësh, në rritje me rreth 75.2% në terma vjetorë.


Grafik 36. Prirja e shpenzimeve kapitale me fonde të veta



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, mesatarisht shpenzimet për personelin rëndojnë me rreth 42.5% në totalin e buxhetit vendor, ndjekur nga shpenzimet operative me rreth 30.4% dhe ato kapitale me rreth 27.1% (bazuar në të dhënat e vitit 2018). Panorama në terma mesatarë tregon për një orientim të bashkive në mbulimin e shpenzimeve të personelit dhe atyre operative dhe për diferenca të theksuara midis tyre. Kështu, vetëm rreth 36% e bashkive (22 bashki) alokojnë më shumë se niveli mesatar prej rreth 27.1% të buxhetit të tyre në investime. Ndërkohë, bashkitë Kukës, Lezhë, Mat dhe Vlorë regjistruan nivelin më të ulët të investimeve të kryera me fonde të veta në vitin 2018.

Grafik 37. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike për 61 bashki (total = 100%)




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.2.2 Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit funksional

Në klasifikimin e shpenzimeve me fonde të veta bazuar në funksionet e qeverisjes (klasifikimi COFOG), rezulton se në vitin 2018, rreth 24.4% e burimeve financiare totale ose rreth 11.8 miliardë lekë u shpenzuan në funksionin “strehimi dhe komoditetet e komunitetit” (+19.2% në terma vjetorë). Brenda këtij funksioni, rreth 10.2 miliardë lekë u alokuan për nën-funksionin e zhvillimit të komunitetit (+16.3% krahasuar me një vit më parë), i cili përmban veprimtari që synojnë përmirësimin e kontekstit të jetesës, si përmirësimi i hapësirave të përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin, përmirësimi i hapësirave të gjelbra, mirëmbajtja e trotuareve, parqeve, lulishteve, etj. Diferenca prej rreth 1.7 miliardë lekësh u shpenzua për nën-funksionet e strehimit, urbanistikës vendore dhe furnizimit me ujë.

Grafik 38. Shpenzimet me fonde të veta sipas klasifikimit funksional



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Shpenzimet në funksionin “çështjet ekonomike”, ku përfshihen ndër të tjera shpenzimet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit rrugor, rezultojnë të jenë tkurrur konsiderueshëm në rreth 10 miliardë lekë në periudhën e konsideruar nga rreth 15.4 miliardë lekë që ishin në vitin 2017 (në rënie me rreth 35.3% në terma vjetorë).

Rritje me rreth 18.2% në terma vjetorë shënuan shpenzimet e dedikuara për funksionin e “arsimit”, rritje e cila vlerësohet të jetë pasojë e funksioneve të reja të transferuara nga qeverisja qendrore drejt asaj vendore (për pagat e personelit mësimdhënës dhe mbështetës në kopshte dhe çerdhe, dhe personelit mbështetës në arsimin fillor dhe të mesëm). Duke filluar prej vitit 2016, shpenzimet e alokuara në këtë funksion janë rritur në mënyrë të ndjeshme dhe progresive nga viti në vit, shpenzime kryesisht të mbuluara nëpërmjet transfertës specifike. Për vitin 2018, në funksionin e arsimit u shpenzuan rreth 9.2 miliardë lekë (niveli më i lartë që prej vitit 2010), ku rreth 82.1% e tyre shkon për mbulimin e kostove të arsimit parashkollor dhe fillor. Në funksion të arsimit të mesëm (për pjesën e funksioneve të mbuluara nga bashkitë) u shpenzuan rreth 1.7 miliardë lekë, në rritje me rreth 3.4% në terma vjetorë.

Funksioni i “mbrojtjes sociale” përthithi rreth 5.2% të shpenzimeve totale, apo rreth 2.5 miliardë lekë (funksion që përfshin shpenzime për strehimin social, papunësinë, familja dhe fëmijët, të moshuarit, sëmundje dhe paaftësitë). Në terma vjetorë, shpenzimet për mbrojtjen sociale rezultojnë të jenë zgjeruar me rreth 61.6% në terma vjetorë.

Shpenzimet me fonde të veta: si paraqiten bashkitë?

Bashkitë e formuara në vijim të reformës administrative dhe territoriale paraqesin diferenca të theksuara në terma të shpenzimeve të kryera me fonde të veta, kushtëzuar nga: (i) numri i popullsisë rezidente në territor, si dhe (ii) kapaciteti fiskal i tyre. Për të pastruar të dhënat nga efekti “madhësi” do të marrim në analizë shpenzimet e kryera nga bashkitë me fonde të veta për një banor (shiko shtojcën 1).²⁶

Transformimi në indekse me bazë 100, lejon për një interpretim të shpejtë dhe evidenton diferencat ndërmjet bashkive në lidhje me kapacitetin për të kryer shpenzime në mënyrë autonome.

Të dhënat për frymë për shpenzimet e kryera me fonde të veta vënë në dukje diferenca të theksuara ndërmjet bashkive në mundësitë për të kryer shpenzime me fonde të veta në periudhën e konsideruar. Bazuar në indeksin mesatar për tre vitet e fundit, rezultojnë se bashkia Himarë paraqet shpenzimet më të larta për frymë (rreth 49,463 lekë) ndjekur nga bashkia Dropull (me rreth 42,563 lekë për frymë).


Në skajin tjetër, bashkia Shkodër rezultojnë të ketë regjistruar nivelin më të ulët të shpenzimeve me fondet të veta për frymë me mesatarisht rreth 10,137 lekë në tre vitet e fundit, ndjekur nga bashkitë Kamëz, Kurbin, Peqin dhe Vau i Dejës. Diferenca e theksuar mes nivelit minimal dhe maksimal të shpenzimeve për frymë me fonde të veta, sinjalizon për ekzistencën e diferencave të thella në kapacitete fiskale të bashkive dhe nevojën për zbutjen e tyre në funksion të ofrimit të shërbimeve publike vendore. Si hap fillestar në këtë drejtim vlerësohet të adresohet llogaritja e kapaciteteve fiskale potenciale të bashkive dhe më tej vlerësimi i performancës së tyre kundrejt potencialit. Më tej, treguesi i performancës që lidhet me normën e mbledhjes së të ardhurave mund të faktorizohet në formulën e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, si element për të neutralizuar diferencat për bashkitë që ndodhen në pozicion fiskal jo të favorshëm.

3.3 Shpenzimet e kryera me fonde nga transferta të kushtëzuara

Krahas shpenzimeve me fonde nga burime të veta, bashkitë kryejnë shpenzime edhe me fonde të kushtëzuara (fonde të cilat transferohen nga institucione qendrore, si ministritë e linjës, dhe që duhet të përdoren sipas qëllimit të përcaktuar). Për këtë kategori të hyrash në buxhetin vendor, bashkitë nuk kanë autoritet vendimmarrjeje në sasinë apo mënyrën e përdorimit të këtyre fondeve: pra, ato shpenzohen sipas përcaktimeve të ministrive të linjës (ndryshe, me destinacion të përcaktuar). Këto fonde transferohen nga buxhetet e ministrive të linjës në trajtën e transfertave të kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara dhe/ose projekteve të veçanta të konsideruara me interes vendor, rajonal apo kombëtar ku kërkohet bashkëpunimi me bashkitë. Ato planifikohen në buxhetet vjetore dhe planet buxhetore afatmesme të ministrive përkatëse. Raporti i zbatimit të buxhetit vjetor të ministrisë të linjës përmban një aneks të dedikuar ku paraqiten transfertat e kushtëzuara, qëllimi i përdorimit të tyre, përfituesi, vlera totale, shuma e lëvruar dhe pjesa e mbetur për tu financuar në vitet në vijim për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ndonëse të parashikuara dhe të transferuara nga buxhetet e njësive qendrore të qeverisjes (si ministritë e linjës), ato reflektohen në totalin e shpenzimeve të kryera prej bashkive.

Në vitet në analizë, shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara kanë ndjekur prirje rritëse, kryesisht në vijim të ndryshimeve të aplikuara në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjet në nevojë. Në total, në vitin 2018 shpenzimet me fondet të kushtëzuara shënuan një nivel prej rreth 33.7 miliardë lekësh, në rritje me rreth 4.7% në terma vjetorë. Ky ritëm rritjeje rezulton të jetë moderuar krahasuar me rritjen dy-shifrore të shënuar në vitin 2017 (+26.2% në terma vjetorë).


Grafik 40. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Bazuar në klasifikimin ekonomik, shpenzimet e kryera me fonde të kushtëzuara janë të përqendruara në dy zëra kryesorë: transfertat për buxhetet familjare (ndihmë ekonomike, pagesa e paaftësisë etj.) dhe shpenzimet kapitale apo investimet (përfshirë FZHR). Ndaj totalit të transfertave të kushtëzuara, fondet e alokuara nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale përfaqësojnë rreth 62% ndaj totalit ose rreth 21 miliardë lekë në fund të vitit 2018 (në rënie të lehtë në terma vjetorë me rreth 0.7%). Në të kundërt, fondet e alokuara për shpenzime kapitale rezultojnë të jenë rritur për të dytin vit radhazi në mënyrë të ndjeshme. Kështu, në vitin 2017 shpenzimet kapitale të financuara me fonde të kushtëzuara shënuan një nivel prej rreth 8.7 miliardë lekësh nga rreth 3.3 miliardë lekë që ishte në vitin 2016. Ndonëse me ritme më të moderuara, investimet me fonde nga institucionet qendrore vijuan të rriten edhe në vitin 2018 duke shënuar një nivel prej rreth 10.3 miliardë lekësh, në rritje me rreth 18.3% në terma vjetorë. Në vitin 2018, investimet e kryera me fonde të kushtëzuara u përqendruan kryesisht në funksionet “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit” (rreth 7.8 miliardë lekë) dhe në “Arsim” (rreth 2.2 miliardë lekë).


Grafik 41. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas natyrës ekonomike



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Në nivel bashkie, 14.9% e fondeve të kushtëzuara për investime u përthithën nga bashkia Tiranë, ndjekur nga bashkitë Korçë (4.4%), Fier (4.0%) dhe bashkitë Librazhd dhe Elbasan me rreth 3.6% respektivisht. Në të kundërt, bashkia Pustec nuk regjistron të ketë ndërmarrë investime me fonde të kushtëzuara. Praktikisht, 23% të bashkive përftuan mbi 2% të fondeve të kushtëzuara për investime ndërsa, 32.8% e tyre përftuan nën 1% të fondeve për këtë qëllim.

Grafik 42. Shpenzimet me fonde të kushtëzuara sipas funksioneve të qeverisjes




Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

3.4 Kosto e qeverisjes vendore në fund të vitit 2018

Në klasifikimin sipas funksioneve të qeverisjes rreth 62.3% e shpenzimeve me fonde të kushtëzuara u shpenzua për funksionin e “Mbrotjes Sociale” dhe rreth 28.2% në funksion “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”. Në funksionin “Arsim” u shpenzuan rreth 7.2% e fondeve të kushtëzuara (pjesa më e madhe e të cilëve në mbulimin e kostove për ofrimin e shërbimit të arsimit parashkollor dhe fillor).

Grafik 43. Përdorimi i burimeve financiare totale



Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Pavarësisht burimit të financimit, në funksion të qeverisjes vendore u shpenzuan rreth 82.1 miliardë lekë në fund të vitit 2018.²⁷ Kjo vlerë rezulton në rritje me rreth 2.4% në terma vjetorë, përcaktuar nga zgjerimi i shpenzimeve korrente. Në ndarjen sipas natyrës ekonomike, shpenzimet korrente përfaqësuan rreth 72.6% dhe shpenzimet kapitale përfaqësuan rreth 27.4% të shpenzimeve totale të kryera në vitin 2018. Historikisht, shpenzimet korrente rëndojnë buxhetet vendore në mënyrë të qenësishme. Gjatë periudhës në analizë, ato shënuan një nivel prej rreth 58.8 miliardë lekë, në rritje me rreth 9.5% në terma vjetorë. Zgjerimi i shpenzimeve korrente u diktua në masë të madhe nga rritja e shpenzimeve operative dhe të tjera me rreth 10.8% në terma vjetorë. Në të njëjtin kah, por në masë më të vogël, kontribuoi, gjithashtu, rritja e shpenzimeve për personelin: në vitin 2018 bashkitë shpenzuan rreth 21.2 miliardë lekë për personelin, në rritje me rreth 7.2% në terma vjetorë. Në të kundërt, shpenzimet për investime shënuan një nivel prej rreth 23.4 miliardë lekësh, në rënie të theksuar prej rreth 12.0% në terma vjetorë.

PËRFUNDIME

Performanca e bashkive në kahun e burimeve financiare totale vlerësohet të jetë moderuar dhe pozitive në fund të vitit 2018. Përmirësimi në terma agregatë i burimeve financiare në dispozicion të bashkive u ndikua pozitivisht nga rritja e të ardhurave nga burime të veta vendore dhe kontributi i transfertës së pakushtëzuar dhe specifike.

Pavarësisht madhësisë së “tortës së burimeve financiare”, struktura e të ardhurave nga burimet e veta vendore mbetet një tregues i rëndësishëm për autonominë fiskale vendore. Përgjatë vitit të fundit, raporti i të ardhurave nga burimet e veta vendore ndaj totalit të burimeve financiare rezulton të jetë 29.1%, vlera më e lartë historike nga viti 2010. Ndonëse në terma të përmbledhur për 61 bashkitë ky tregues rezulton në përmirësim, analiza e detajuar në nivel bashkie dhe sipas zërave specifike, sinjalizon për një gjendje delikate të autonomisë vendore. Kështu, përmirësimi treguesit është përcaktuar nga rritja e të ardhurave në një numër të kufizuar bashkish dhe në buxhetet e tyre, ky përmirësim është diktuar nga rritja e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Natyra e paqëndrueshme e të ardhurave nga kjo taksë (sezonaliteti dhe përqendrimi i presionit zhvillimor në një numër të kufizuar bashkish, apo qenia subjekt i politikave zhvillimore) dhe mbledhja e mbi 75% e të ardhurave prej saj në tre bashki, sinjalizon për dobësi strukturore në autonominë fiskale vendore. Në të kundërt, të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme sinjalizojnë për ecuri pozitive në vitin e fundit dhe pritshmëri për rritje të peshës të saj në burimet e veta vendore (në vijim të aplikimit të metodologjisë së re bazuar në vlerën e pronës). Në këtë kontekst, do të ishte me vlerë përcaktimi i potencialit teorik të të ardhurave që mund të mblidhen nga kjo taksë, për të lehtësuar dhe monitoruar më tej administrimin e saj nga bashkitë në vend (norma e mbledhjes së taksës ndaj potencialit).

Zgjerimi i shpenzimeve publike vendore vijon të përcaktohet gjerësisht nga ecuria e shpenzimeve korrente (shpenzimeve për personelin dhe atyre operative). Shuarja e efektit të transferimit të funksioneve të reja në vitin 2016, dhe prania e një prirje rritëse në këtë kategori shpenzimesh nuk mbështet një ndër argumentet kryesore në bazë të reformës administrative dhe territoriale: rritjen e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike. Njëkohësisht, rezulton e vështirë të vlerësohet nëse, rritja e shpenzimeve korrente është përkthyer apo jo në shërbime më të mira për qytetarët. Në kah të kundërt, shpenzimet kapitale rezultojnë të jenë tkurrur gjatë vitit 2018, me fonde të veta dhe të kushtëzuara.

Shtojcë 1. Shpenzimet me фонде të veta për frymë

	2015	2016	2017	2018	Mesatare 2016-2018	Indeks
Belsh	5,287	13,329	14,945	9,894	12,723	77
Berat	12,836	18,645	14,448	14,550	15,881	96
Bulqizë	11,644	12,906	12,455	13,648	13,003	78
Cërrik	6,404	11,846	11,689	10,334	11,290	68
Delvinë	10,207	25,512	22,789	23,690	23,997	145
Devoll	5,821	10,856	12,410	12,657	11,974	72
Dibër	6,358	11,112	14,275	11,150	12,179	73
Divjakë	10,962	20,791	12,848	11,850	15,163	91
Dropulli	24,077	40,249	38,513	48,928	42,563	257
Durrës	13,998	13,816	14,950	12,982	13,916	84
Elbasan	10,470	13,738	11,832	12,257	12,609	76
Fier	11,174	16,089	15,157	13,271	14,839	89
Finiq	12,362	13,555	26,428	31,901	23,961	145
Fushë_Arrë	11,839	17,424	22,335	33,404	24,388	147
Gjirokastër	18,138	22,939	21,297	18,689	20,975	127
Gramsh	9,327	13,378	20,562	17,107	17,016	103
Has	11,725	15,598	15,105	14,782	15,161	91
Himarë	39,886	66,237	36,899	45,256	49,464	298
Kamëz	6,905	8,003	10,797	13,924	10,908	66
Kavajë	21,925	23,714	16,837	18,235	19,595	118
Këlcyrë	10,319	25,989	34,787	23,871	28,216	170
Klos	6,971	9,670	11,845	13,623	11,713	71
Kolonjë	14,993	24,455	33,893	30,056	29,468	178
Konispol	8,054	18,013	29,406	16,612	21,344	129
Korçë	19,344	21,890	25,916	18,812	22,206	134
Krujë	8,776	10,905	11,615	11,053	11,191	67
Kuçovë	14,254	10,803	11,786	13,072	11,887	72
Kukës	7,731	10,313	14,142	12,338	12,264	74
Kurbin	6,078	7,743	13,839	9,701	10,428	63
Lezhë	14,897	11,058	13,411	13,326	12,598	76
Libohovë	13,391	23,981	38,108	34,579	32,223	194
Librazhd	10,193	15,491	19,251	19,257	18,000	109
Lushnjë	11,482	12,674	12,372	12,016	12,354	75
Malësi e M	5,216	12,993	16,725	14,903	14,873	90
Maliq	5,282	11,252	16,788	14,163	14,068	85

Mallakaste	9,205	12,821	15,585	16,620	15,009	91
Mat	12,080	13,665	15,318	13,122	14,035	85
Memaliaj	13,497	12,014	17,506	17,801	15,774	95
Mirditë	14,218	18,348	30,729	19,363	22,813	138
Patos	10,711	14,058	19,826	22,109	18,664	113
Peqin	5,316	8,515	12,604	9,814	10,311	62
Përmet	12,971	26,240	28,717	22,132	25,697	155
Pogradec	7,452	9,050	10,787	12,591	10,809	65
Poliçan	10,095	19,283	22,352	20,898	20,845	126
Prrenjas	5,265	7,494	12,894	12,720	11,036	67
Pukë	17,493	21,698	22,126	21,425	21,750	131
Pustec	11,180	11,954	17,585	13,749	14,429	87
Roskovec	8,746	21,442	17,467	22,441	20,450	123
Rrogozhinë	7,794	15,126	14,383	13,635	14,381	87
Sarandë	31,087	24,088	25,463	27,915	25,822	156
Selenicë	11,227	12,929	19,402	23,058	18,463	111
Shijak	11,990	11,670	13,048	16,046	13,588	82
Shkodër	7,474	8,309	10,315	11,790	10,138	61
Skrapar	24,228	36,164	30,662	26,454	31,093	188
Tepelenë	23,427	26,440	35,912	28,913	30,421	183
Tiranë	14,820	20,853	23,728	26,987	23,856	144
Tropojë	11,355	19,122	17,034	17,883	18,013	109
Ura_Vajgur	6,761	12,133	11,430	15,006	12,856	78
Vau I Dejës	7,864	10,510	11,432	10,302	10,748	65
Vlorë	9,258	11,077	16,617	14,683	14,126	85
Vorë	15,563	23,617	17,937	26,559	22,704	137
Total	11,736	15,400	17,097	17,245	16,581	100

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

Shtojcë 2. Shpenzimet kapitale me fonde të veta për frymë

	2015	2016	2017	2018	Mesatare 2016-2018	Indeks	% e shpenzimeve kapitale / shpenzimeve totale me fonde të veta për frymë
Belsh	1,462	7,262	6,721	1,253	5,078	90	39.9%
Berat	5,315	8,801	3,363	2,729	4,965	88	31.3%
Bulqizë	6,071	4,625	3,242	3,059	3,642	64	28.0%
Cërrik	1,187	4,447	3,374	1,692	3,171	56	28.1%
Delvinë	1,167	10,742	6,336	5,766	7,615	134	31.7%
Devoll	1,248	3,300	2,848	1,813	2,654	47	22.2%
Dibër	1,437	3,863	4,411	2,192	3,489	62	28.6%
Divjakë	6,231	14,256	4,692	2,246	7,065	125	46.6%
Dropulli	4,807	14,255	9,318	12,191	11,921	210	28.0%
Durrës	7,333	5,757	6,616	3,693	5,355	95	38.5%
Elbasan	3,935	5,473	2,273	1,425	3,057	54	24.2%
Fier	4,703	7,078	5,216	2,603	4,966	88	33.5%
Finiq	1,960	2,087	9,428	10,690	7,402	131	30.9%
Fushë Arrë	2,820	3,300	7,022	11,587	7,303	129	29.9%
Gjirokastër	8,688	9,142	6,597	2,145	5,961	105	28.4%
Gramsh	1,680	3,198	8,008	4,315	5,174	91	30.4%
Has	6,124	6,735	5,018	2,890	4,881	86	32.2%
Himarë	20,305	44,825	13,948	14,089	24,287	429	49.1%
Kamëz	3,317	3,355	5,741	8,054	5,717	101	52.4%
Kavajë	14,030	12,854	3,610	2,807	6,424	113	32.8%
Këlcyrë	1,170	16,704	21,431	7,705	15,280	270	54.2%
Klos	1,796	2,318	3,111	2,986	2,805	50	23.9%
Kolonjë	3,750	9,047	14,785	8,855	10,896	192	37.0%
Konispol	448	8,670	17,000	3,495	9,722	172	45.5%
Korçë	10,053	9,323	12,236	3,685	8,415	149	37.9%
Krujë	3,381	4,343	4,137	2,550	3,677	65	32.9%
Kuçovë	7,121	2,524	1,271	1,347	1,714	30	14.4%
Kukës	578	1,115	2,705	572	1,464	26	11.9%
Kurbin	1,265	652	5,377	1,266	2,432	43	23.3%
Lezhë	7,065	1,756	2,513	451	1,573	28	12.5%
Libohovë	2,062	11,614	24,592	18,088	18,098	319	56.2%
Librazhd	4,817	7,970	9,853	7,779	8,534	151	47.4%
Lushnjë	5,226	4,373	3,061	2,230	3,221	57	26.1%
Malësi Ma	485	6,720	9,438	6,146	7,435	131	50.0%
Maliq	1,218	4,797	8,181	4,771	5,916	104	42.1%
Mallakastër	2,545	2,867	6,171	5,437	4,825	85	32.1%
Mat	5,592	4,290	3,543	999	2,944	52	21.0%
Memaliaj	5,965	2,587	6,784	4,402	4,591	81	29.1%
Mirditë	5,516	6,751	17,298	5,337	9,795	173	42.9%
Patos	3,326	4,668	8,802	6,117	6,529	115	35.0%
Peqin	648	3,012	5,087	1,403	3,167	56	30.7%
Përmet	1,987	12,465	13,091	3,436	9,664	171	37.6%
Pogradec	1,476	1,254	2,331	3,060	2,215	39	20.5%
Poliçan	1,576	7,524	6,829	3,019	5,791	102	27.8%
Prrenjas	484	886	5,018	3,127	3,010	53	27.3%
Pukë	7,643	8,404	5,377	4,634	6,138	108	28.2%
Pustec	4,185	2,260	6,425	1,446	3,377	60	23.4%

Roskovec	2,591	13,432	8,370	11,190	10,997	194	53.8%
Rrogozhinë	947	6,452	3,814	1,827	4,031	71	28.0%
Sarandë	14,334	3,652	5,533	6,560	5,249	93	20.3%
Selenicë	4,790	4,347	9,732	10,310	8,130	144	44.0%
Shijak	7,398	3,481	3,832	5,678	4,331	76	31.9%
Shkodër	1,588	696	2,184	2,045	1,642	29	16.2%
Skrapar	10,904	18,044	9,294	4,997	10,779	190	34.7%
Tepelenë	13,453	11,887	17,343	9,543	12,924	228	42.5%
Tiranë	5,348	8,499	10,065	9,372	9,312	164	39.0%
Tropojë	4,684	9,100	6,085	5,177	6,787	120	37.7%
Ura_Vajgur	799	6,441	5,033	7,042	6,172	109	48.0%
Vau I Dejës	2,860	5,330	4,969	2,639	4,313	76	40.1%
Vlorë	744	1,350	5,176	875	2,467	44	17.5%
Vorë	7,598	13,408	7,762	11,207	10,792	191	47.5%
Total	4,517	5,958	6,368	4,670	5,665	100	34.2%

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

Shtojcë 3. Të ardhura nga burime të veta vendore për frymë

	2015	2016	2017	2018	Mesatare 2016-2018	Indeks
Belsh	969	4,012	2,158	1,880	2,683	37
Berat	4,449	4,296	5,742	5,128	5,055	69
Bulqizë	1,192	1,382	1,765	1,371	1,506	21
Cërrik	2,055	3,611	2,699	2,687	2,999	41
Delvinë	2,738	6,103	5,808	3,363	5,091	70
Devoll	1,771	2,406	2,298	2,749	2,484	34
Dibër	993	1,065	1,103	1,034	1,067	15
Divjakë	2,105	2,712	2,261	2,847	2,606	36
Dropulli	10,739	13,810	13,897	12,487	13,398	183
Durrës	6,712	6,739	7,451	6,948	7,046	96
Elbasan	3,579	3,849	4,449	4,556	4,285	59
Fier	3,983	3,638	4,340	5,116	4,365	60
Finiq	3,107	4,879	5,574	5,782	5,412	74
Fushë_Arrë	1,727	2,631	2,627	2,625	2,628	36
Gjirokastër	4,769	4,854	4,707	5,244	4,935	68
Gramsh	2,502	1,709	2,239	2,540	2,163	30
Has	718	716	841	774	777	11
Himarë	14,007	20,763	19,770	23,204	21,246	291
Kamëz	3,921	4,794	5,529	7,509	5,944	81
Kavajë	5,830	6,926	8,256	9,357	8,180	112
Këlcyrë	1,803	1,553	1,734	1,903	1,730	24
Klos	1,038	1,712	1,426	1,672	1,603	22
Kolonjë	3,363	3,190	3,883	4,417	3,830	52
Konispol	3,359	5,216	5,142	3,917	4,758	65
Korçë	5,556	7,221	7,166	7,951	7,446	102
Krujë	3,118	4,493	3,687	5,353	4,511	62
Kuçovë	3,210	3,052	4,074	3,776	3,634	50
Kukës	1,613	1,918	1,695	1,561	1,725	24
Kurbin	1,232	1,306	1,543	1,337	1,395	19
Lezhë	4,375	4,281	5,012	6,098	5,130	70
Libohovë	2,096	3,087	3,210	2,966	3,088	42
Librazhd	1,896	2,418	2,917	3,345	2,893	40
Lushnjë	3,372	4,026	3,863	4,020	3,970	54
Malësi Ma	1,324	4,180	1,177	1,973	2,444	33
Maliq	1,323	1,967	2,138	2,922	2,342	32

Mallakaste	3,915	7,245	7,902	11,564	8,904	122
Mat	1,803	1,800	2,381	1,924	2,035	28
Memaliaj	1,292	1,590	1,335	1,020	1,315	18
Mirditë	1,222	2,178	1,594	2,424	2,065	28
Patos	4,454	4,791	4,277	9,257	6,108	84
Peqin	1,547	1,845	1,482	1,742	1,690	23
Përmet	3,242	3,841	2,883	3,699	3,474	48
Pogradec	2,431	3,086	3,677	3,908	3,557	49
Poliçan	3,287	3,844	3,858	2,916	3,539	48
Prrenjas	1,566	1,934	1,921	1,975	1,944	27
Pukë	1,920	2,361	1,670	2,020	2,017	28
Pustec	975	1,174	1,101	350	875	12
Roskovec	7,056	8,245	9,265	6,875	8,128	111
Rrogozhinë	2,996	3,164	3,510	3,906	3,527	48
Sarandë	11,331	13,223	14,754	15,690	14,555	199
Selenicë	2,359	3,072	4,072	3,391	3,512	48
Shijak	5,193	6,111	5,335	4,824	5,424	74
Shkodër	3,280	3,421	4,156	4,703	4,093	56
Skrapar	5,421	7,209	6,200	5,320	6,243	85
Tepelenë	1,997	2,353	4,056	4,091	3,500	48
Tiranë	8,786	13,023	18,307	23,487	18,272	250
Tropojë	1,734	4,196	2,055	2,381	2,877	39
Ura_Vajgur	2,991	2,794	3,414	4,257	3,488	48
Vau I Dejës	3,130	3,220	2,426	3,734	3,126	43
Vlorë	4,128	4,942	5,498	6,359	5,600	77
Vorë	10,580	13,727	14,766	15,932	14,808	203
Total	4,663	5,993	7,263	8,652	7,303	100

Burimi: Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al & INSTAT

¹Në këtë platformë ju mund të ndërtoni vetë raportin tuaj për të monitoruar nga burojnë të ardhurat vendore dhe si shpenzohen ato nga bashkia juaj.

²Shiko: http://www.seecities.eu/seecities.eu/Portals/0/Images/Stories/Publications/MFSA%20Brochure_Final_Web_PA.pdf?ver=2018-09-10-071023-543U <https://www.oecd.org/regional/regional-policy/Subnational-Governments-Around-the-World-%20Part-I.pdf>

³Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

⁴Të dhënat për EJL dhe BE i referohen vitit 2017. Për më shumë informacion në lidhje me mënyrën e llogaritjes së tyre shiko: Fiscal Decentralization Indicators for South – East Europe, December 2018 (NALAS).

⁵Idem shënim 4.

⁶Llogaritur si mesatare e thjeshtë e vlerave të raportit të të ardhurave nga burime të veta vendore ndaj burimeve financiare totale për periudhën 2010-2017.

⁷Burimi: Fiscal Decentralization Indicators for South-East Europe, December 2018, NALAS

⁸Të dhënat e përdorura në këtë analizë i referohen atyre të përmbajtura në dokumentin e Planit Buxhetor Afatmesëm 2018 – 2020 të cilat janë të publikuara në platformën www.financatvendore.al dhe në faqet web të bashkive. Nuk janë të përfshira këtu ndryshimet e mundshme buxhetore të miratuara nga Këshillat Bashkiakë.

<http://www.financa.gov.al/nuk-ka-shtyrje-te-aplikimit-te-taksese-prones-procesi-ka-filluar-dhe-po-vazhdon/>

¹⁰Bazuar në Ligjin nr. 68/2018 "Mbi financat e vetëqeverisjes vendore", në nenin 11, pika 2 citohet se taksa mbi pasurinë e paluajtshme përfshin "taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to". Në linjë me përcaktimet ligjore, të ardhurat nga taksa mbi kalimin e të drejtave të pronësisë për pasuritë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë.

¹²Burimi: <http://www.instat.gov.al/temat/statistikat-e-p%C3%ABrgjithshme-dhe-rajonale/tregues-sipas-bashkive/#tab2>

¹³Rënia progresive e të ardhurave nga kjo taksë vjen në vijim të ndryshimeve në Ligjin nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar sipas të cilit duke filluar nga viti 2016 të gjitha bizneset e vogla me xhiro vjetore nën 5 milionë lekë janë përjashtuar nga detyrimi tatimor, ndërkohë që për bizneset e vogla me xhiro vjetore nga 5-8 milionë lekë shkalla tatimore u përgjysmua.

¹⁴Burimi: Regjistri i Borxhit 2018T4 <https://financa.gov.al/regjistri-i-borxhit/>

¹⁵PBB nominale sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Treguesit Fiskal).

¹⁶Të dhëna sipas Census 2011.

¹⁷Në këtë analizë, ky zë u përfshi në të ardhurat nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme dhe nuk do të trajtohet si taksë e ndarë.

¹⁸Bazuar në të dhënat fiskale të qeverisë për vitin 2017 u mbledhën rreth 32.1 miliard lekë të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe 2% e tyre apo 642.1 milionë lekë do të duhet të ishte pjesa e ndarë me bashkitë.

¹⁹Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 23, "shuma totale e transfertës së pakushtëzuar, pas përfundimit të periudhës tranzitore të transferimit të funksioneve të reja në nivel vendor, rritet me madhësinë e transfertave specifike që vendoset të përfshihen brenda transfertës së pakushtëzuar" dhe Aneksi 1, Formula e Transferit të Pakushtëzuar (MoFE).

²⁰Në Shtator të vitit 2017, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë u shkri dhe programet e mbrojtjes sociale i kaluan portofolit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

²¹Burimet financiare totale të njësive të vetëqeverisjes vendore përfshijnë: (i) të ardhurat nga burime të veta vendore (taksa, tarifa, të tjera dhe huamarrje), (ii) të ardhura nga transfertat ndërqeveritare ku përfshihen të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar dhe specifike, (iii) të ardhurat nga taksat e ndara, dhe (iv) të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara.

²²Kjo shifër nuk përfshin të ardhurat nga fondet e trashëguara nga viti i mëparshëm (të kushtëzuara apo jo). Ndërkohë, përfshihen të ardhurat nga transfertat e kushtëzuara, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku ndër burimet e financimit të bashkive përfshihet edhe kjo kategori.

²³Transferta specifike deri më tani është trajtuar si transfertë me destinacion, por në buxhetin e vitit 2019 parashikohet të jetë pjesë e transfertës së pakushtëzuar, por e dedikuar për sektorët që synon të financojë.

²⁴Kjo shifër përfshin të gjitha shpenzimet e kryera nga bashkitë, me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara.

²⁵Shpenzimet e personelit për funksionet e reja mbulohe me fonde nga transfertat specifike. Nëse bashkitë duan të performojnë më mirë apo të rritin cilësinë e këtyre shërbimeve, kostot do të duhet të mbulohe me burime të tjera të pakushtëzuara.

²⁶Përfshin shpenzime operative, subvencione, transfertat dhe interesa.

²⁷Bazuar në të dhënat për popullsinë sipas Census 2011.

²⁸Kjo shifër përfshin të gjitha shpenzimet e kryera nga bashkitë, me fonde të veta dhe me fonde të kushtëzuara.

